

Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC)

Raporti Vjetor 2022

I. Mesazh i Drejtorit Ekzekutiv

II. Profili i Korporatës Shqiptare të Investimeve – Kush Jemi Ne

III. Vlerat dhe Parimet Tona

IV. Performanca në vitin 2022: Ngjarjet Kryesore

- Organizimi i Brendshëm
- Bashkëpunimi me stakeholders
- Aktivitete të AIC
- Zhvillimi i një *project pipeline* investimesh
- Sigurimi i rritjes së nevojshme të kapitalit për financimin e aktiviteteve investuese

V. Sfidat dhe objektivat për 2023

Mesazh nga Drejtori Ekzekutiv

Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC), si një kapacitet i shtetit për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimit, tashmë ka hyrë në vitin e saj të dytë të funksionimit.

Ngritja e një institucioni të ri është sfiduese në çdo situatë normale dhe ajo që bën diferencën në kthimin e një ideje në realitet është bindja në drejtësinë e misionit, puna për realizimin e detyrave, dhe përkushtimi në arritjen e objektivave.

Në rastin e AIC, puna e bërë për identifikimin e aseteve që mund të rivitalizohen nëpërmjet projekteve të investimit dhe zhvillimit, ka treguar potencialin që mund të shfrytëzohet në vend, si dhe nevojën që ka Shqipëria për të pasur një organizatë si AIC. Është ky ndërgjegjësimit që përfitohet gjatë rrugës ai që i jep motivimin kryesor ekipit dhe organizatës.

Siç mund të shihet në këtë Raport Vjetor për 2022, AIC tashmë ka marrë formë dhe aktualisht ka një ekip prej 13 ekspertësh të angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme, të cilët kanë analizuar dhjetra asete shtetërore të nën përdorura dhe projekte zhvillimi, duke prioritetizuar projekte komplekse në fushat e industrisë dhe logjistikës, inovacionit dhe teknologjisë, gjenerimit të energjisë të rinovueshme dhe turizmit.

Viti 2023 e gjen AIC të përgatitur për të avancuar dhe zbatuar këto projekte.

Disa nga sfidat e identifikuara në Raportin Vjetor të 2021 mbeten ende aktuale. Marrëdhënia me publikun do të vazhdojë të mbetet një prioritet, të cilin AIC do e adresojë efektivisht nëpërmjet punës së saj për të ndërgjegjësuar palët e interesuara për misionin për të cilin AIC është ngritur dhe pritshmërinë ndaj saj.

Në përfundim, dëshiroj të falënderoj ekipin e AIC, si dhe partnerët dhe bashkëpunëtorët e saj për përkushtimin, punën, besimin dhe mbështetjen në këtë përpjekje për transformimin e ekonomisë së vendit.

@Ermal Frashëri, Drejtor Ekzekutiv

AIC Albanian
Investment
Corporation

1

Profili i Korporatës Shqiptare të Investimeve

KUSH JEMI NE?

Korporata Shqiptare e Investimeve u krijua me Ligjin Nr. 71/2019 si një institucion me qëllim të dyfishtë, përkatësisht për:

- Realizimin e projekteve të qëndrueshme të investimit;
- Krijimin e impaktit në ekonomi nëpërmjet diversifikimit të saj dhe rritjes së punësimit, në përmbushje të objektivave publike të zhvillimit.

Vizioni dhe misioni i AIC-së kërkojnë që AIC të angazhohet në:

- Përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimit, sidomos ato projekte në të cilat sektori privat has vështirësi për shkak të një shkalle të lartë kompleksiteti dhe koordinimi të inuteve publike;
- Rivitalizimin e asetëve publike për tu menaxhuar në mënyrë me efektive dhe efçente;
- Strukturimin financiar dhe ligjor të propozimeve të ndryshme të investimit;
- Transformimin e inuteve publike në kapital në projektet e investimit.

Konceptimi i AIC-së erdhi si nevojë e krijimit të një kapaciteti shtetëror për të kryer funksionet e mësipërme duke u bazuar mbi një analizë të ekosistemit institucional në vend si edhe shembujve të suksesshëm nga vende të zhvilluara dhe në zhvillim, ku kapacitete si AIC kanë arritur të transformojnë ekonominë përkatëse.

Në Korrik të 2021 u realizua konstituimi i Bordit Mbikëqyrës dhe AIC u operacionalizua.

2

Vlerat dhe parimet Tona

AIC është një korporatë ku aksioneri i saj fundor është publiku, dhe si e tillë, AIC vepron si një entitet privat që i përgjigjet objektivave publike, lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit.

Vlerat dhe Parimet

Në këtë frymë, AIC synon të krijojë një model të mirëqeverisjes korporative dhe shembull për korporatat e tjera në sektorin publik dhe atë privat në vend. Në punën e përditshme, në marrëdhëniet brenda saj por edhe në raport me partnerët, AIC udhëhiqet nga vlerat dhe parimet e mëposhtme:



Vlerat dhe Parimet

- **Interesi Publik:** Duke qenë një kompani shtetërore vendosim në themel të zhvillimit të biznesit dhe realizimit të fitimeve të Korporatës interesin publik. Projektet tona synojnë të mbështesin dhe zhvillojnë ekonominë lokale.
- **Integriteti:** Ne veprojmë sipas standardeve më të larta etike, duke vepruar në mënyrë të drejtë, transparente dhe të ndershme.
- **Dëshira për ekselencë:** Ne përpiqemi të arrijmë më të mirën në çdo gjë që bëjmë dhe të guxojmë të ndërmarrin risqe me përgjegjshmëri.
- **Puna në ekip:** Ne punojmë së bashku me besim, korrektësi dhe respekt reciprok
- **Motivimi i Punonjësve:** Ne duam të ndërtojmë një kulturë pune ku punonjësit të ndihen të motivuar, të vlerësuar dhe të rriten profesionalisht. Punonjësit tanë bëjnë diferencën dhe janë aset më me vlerë i Korporatës.

3

Performanca gjatë vitit 2022

NGJARJET KRYESORE

Në këtë raport pasqyrohen zhvillimet kryesore të AIC-së gjatë vitit 2022, të ndara në 5 (pesë) kategori, përkatësisht:

- 1) Organizimi i brendshëm - vazhdimi i ndërtimit të ekipit bazë dhe kapaciteteve të brendshme;
- 2) Marrëdhëniet me institucionet e tjera;
- 3) Aktivitete të AIC-së;
- 4) Zhvillimin e një *project pipeline* investimesh, si dhe
- 5) Sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit për financimin e aktiviteteve investuese.



Organizimi i Brendshëm

vazhdimi i ndërtimit të ekipit bazë dhe kapaciteve të brendshme.

Duke qenë një korporatë e re, e operacionalizuar vetëm gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, në fokus të AIC vazhdon të jetë rritja e aftësive profesionale dhe krijimi i *know-how* për të përmbushur misionin për të cilin u krijua.

Burimet njerëzore – Bazuar në nevojën për të rekrutuar ekspertë me aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të AIC-së, aktualisht Korporata ka ndërtuar një ekip prej 13 ekspertësh, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përfshirë ekipin menaxherial ku bëjnë pjesë drejtorët e Divizioneve të Zhvillimit të Biznesit, të Financës dhe Administratës si dhe atij Ligjor.

Bordi Mbikëqyrës - Bordi Mbikëqyrës është organi vendimmarrës për drejtimin e AIC-së. Anëtarët e Bordit janë personalitete të mirënjohura në fushat respektive – financë, zhvillim ekonomik, e drejtë korporatash – dhe kanë ekspertizën e nevojshme për të facilituar mirëfunksionimin e AIC-së si edhe për të rritur kredibilitetin e Korporatës tek partnerët vendas dhe të huaj, përfshirë institucionet financiare multilaterale. Komunikimet ndërmjet Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit kanë qenë frekvente, duke garantuar diskutimin në mënyrë konsistente të progresit të AIC-së, zhvillimin e projekteve, ngritjen e marrëdhënieve me partneret, sfidat dhe zgjidhjet për to.

Qeverisja korporative - Në funksion të forcimit të kapaciteteve qeverisëse korporative, ekipi i AIC ka adoptuar kornizën rregullatore për mirëfunksionimin e saj, konkretisht Rregulloren e Brendshme dhe Kodin e Qeverisjes së Mirë dhe Etikës. Vazhdon puna për përgatitjen e akteve të tjera të nevojshme.

Gjithashtu janë realizuar rregullisht raportimet rregullatore tek organet shtetërore si ato tatimore por edhe tek organe të tjera, në zbatim të detyrimeve ligjore, siç është edhe raportimi për konsumin e energjisë elektrike mujore tek Task Forca e Energjisë, në zbatim të Aktit normativ nr.14, datë 5.10.2022 "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike".

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Përgjatë vitit 2022, AIC ka zhvilluar dhe mbajtur raporte të vazhdueshme me partnerë institucionalë, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Bashkia e Tiranës, Bashkia Korçë, me organizata multilaterale dhe po kështu me organizata simotra në vende të tjera, për të identifikuar projekte dhe për të shkëmbyer informacione për investime e investitorë potencial.

Në kuadër të zhvillimit të një marrëdhënie bashkëpunimi me këto institucione, AIC ka vijuar me formalizimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse, konkretisht me Ministrinë e Mbrojtjes, Bashkinë Korçë dhe Shoqatën e Investimeve të Huaja në Shqipëri.

Elementët e bashkëpunimit me institucionet sa më sipër janë të detajuara më poshtë:

Marrëdhëniet me institucionet e tjera



AIC – Bashkia Tiranë

Në Shtator të vitit 2021, si pjesë e krijimit të marrëdhënieve me institucione kryesore për të eksploruar projekte të mundshme investimi me përfitim reciprok, AIC nisi bashkëpunimin me Bashkinë e Tiranës, i cili u formalizua me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi në dhjetor të vitit 2021.

AIC u investua në kuadër të kërkimit dhe krijimit të bazës ligjore dhe aspekteve të tjerë të nevojshëm për ndërtimin e një Tekno parku në afërsi të Tiranës.

Në këtë linjë, AIC u angazhua në kërkimin e praktikave më të mira të ngritjes dhe operimit të tekno parqeve në Evropë si dhe hartoi një projekt-ligj, i cili u miratua në korrik të vitit 2022.

Për vitin 2023, marrëdhënia me Bashkinë e Tiranës pritet të intensifikohet nëpërmjet bashkëpunimit në projekte zhvillimore të qytetit të Tiranës fokusuar kryesisht në fushën e teknologjisë, inovacionit, industrisë, bujqësisë, etj.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

AIC – Bashkia Korçë

Në dhjetor të 2022, AIC dhe Bashkia Korçë nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi për të punuar së bashku në identifikimin e projekteve të cilat do ti japin një nxitje zhvillimit lokal të kësaj bashkie dhe që priten të bëhen më konkrete gjatë vitit 2023.



Marrëdhëniet me institucionet e tjera

AIC – Ministria e Mbrojtjes

Në kuadër të rivitalizimit të aseteve shtetërore të nën përdorura, AIC dhe Ministria e Mbrojtjes nënshkruan në korrik të vitit 2022 një Marrëveshje Bashkëpunimi për identifikimin e projekteve me potencial komercial dhe që kanë impakt në zhvillimin e vendit. Aktualisht janë evidentuar asete të cilat pritet ti transferohen AIC me qëllim zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

AIC – Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bashkëpunimi ndërmjet AIC dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2022, duke qenë se MFE është përfaqësuesi i aksionerit shtet, por nga ana tjetër, administron asete të cilat kanë potencial komercial dhe impakt në zhvillimin ekonomik të vendit.

AIC ka kërkuar informacion lidhur me disa asete që përkojnë me fushat e veprimtarisë së AIC-së si zona industriale (për shembull, TEDA-t, ish Uzinën e Telave Shkodër).

Gjithashtu AIC dhe MFE kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm, përgjatë 2022 edhe për sa i përket hartimit të akteve nënligjore me qëllim krijimin e kuadrit të plotë normativ, të nevojshëm për funksionalitetin e AIC. Miratimi i akteve përkatëse pritet të finalizohet gjatë 2023.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

AIC – Shoqata e Investimeve të Huaja në Shqipëri (FIAA)

Në kuadër të krijimit të marrëdhënieve dhe tërheqjes së investitorëve potencialë, AIC ka nënshkruar në dhjetor të vitit 2022, një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Investimeve të Huaja në Shqipëri me qëllim ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive dhe dhënien e ndihmës reciproke në përmbushjen e misioneve të dy institucioneve.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, AIC dhe FIAA kanë rënë dakord të shkëmbejnë informacione, të kryejnë vizita dhe aktivitete të tjera të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve të tyre përkatëse si dhe të promovojnë njëra-tjetrën në forume/konferenca dhe takime të ndryshme investitorësh me qëllim përthithjen e tyre për realizimin e investimeve në projekte të ndryshme.

Aktivite të AIC

AIC është një korporatë e re dhe si e tillë aktivitetet, qoftë për sa i përket prezantimit me palët e ndryshme të interesit në kuadër të zhvillimit të projekt ideve, investitorët potencialë, por edhe aktivite të cilat kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive të brendshme, janë të një rëndësie të vecantë për të.

Për këtë arsye, AIC gjatë vitit 2022 është angazhuar në rritjen e profilit të saj qoftë në mjediset e forumet e investitorëve potencial por edhe në institucionet qendrore dhe vendore më të cilat AIC ka vendosur ura komunikimi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

Komunikimi i rolit dhe profilit të AIC si një mekanizëm i shtetit shqiptar për të krijuar një sinergji të re në bashkëpunimin publik-privat ka qenë dhe do të jetë një sfidë e rëndësishme për AIC, kjo për shkak edhe të mos ekzistencës së një modeli të ngjashëm më parë, por gjithsesi një praktikë e njohur dhe e suksesshme në botë.

Gjatë vitit 2022, ekipi i AIC ka marrë pjesë në një numër aktivitetesh brenda dhe jashtë vendit me synim forcimin e profilit dhe kapaciteteve, përfaqësimin në konferenca ndërkombëtare investitorësh, raportim periodik në Nën-Komitetin e çështjeve ekonomike të Komisionit Evropian lidhur me veprimtarinë e AIC, si dhe shkëmbimin e eksperiencave me organizata simotra në Jordani dhe Greqi, etj.

Aktivite të AIC

Vizitë zyrtare në Aqaba Development Corporation (ADC) – Jordani

Vizita në Aqaba u zhvillua mes një grupi përfaqësuesish të nivelit të lartë nga Korporata e Investimeve Shqiptare me drejtuesit e nivelit të lartë në Korporatën Zhvillimore të Aqabas (ADC). Kjo vizitë kishte për qëllim marrjen e njohurive dhe përvojës nga ADC, një korporatë model e cila ka zhvilluar dhe ekzekutuar me sukses shumë projekte në fusha si infrastruktura, turizmi, portet, zonat ekonomike etj. Vizita u mbyll me premtimin për vazhdimin e bashkëpunimit mes të dy institucioneve dhe nënshkrimin shumë shpejt të një Memorandumi Mirëkuptimi.



Aktivite të AIC

Pjesëmarrje e AIC në Tirana Economic Forum

Forumi Ekonomik i Tiranës është një takim mes liderave shqiptarë dhe ndërkombëtarë të nivelit të lartë politik, intelektual dhe korporatave, me një impakt dhe influencë të gjerë, me qëllim adresimin e sfidave kryesore me të cilat po përballlet Shqipëria dhe bota së fundmi.

Gjatë sesionit "Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm investimi në Shqipëri: konsolidimi bankar, pasuritë e paluajtshme dhe turizmi", AIC paraqiti një prezantim të rolit të saj në ekonomi, projekt idetë konkrete në sektorët përkatës, si dhe zhvillimin e tyre, aktivitetet e ardhshme të planifikuara etj.

Pjesëmarrje e AIC në MINEX EUROPE 2022

Forumi MINEX Europe ofron një platformë aktive për përhapjen e teknologjive inovative dhe promovimin e mundësive të investimeve dhe praktikave më të mira për minierat dhe eksplorimin në të gjithë Evropën.

Korporata e Investimeve Shqiptare me pjesëmarrje në sesionin 3 "E tashmja dhe e ardhmja e minierave të qëndrueshme dhe tranzicioni i energjisë larg qymyrit dhe drejt burimeve të rinovueshme në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë në Evropë", prezantoi disa informacione kryesore në lidhje me rolin e Korporatës Shqiptare të Investimeve në zhvillimin e asetëve shtetërore të pashfrytëzuara dhe kontributin në mobilizimin e investimeve private në sektorë që kanë potencial të madh për të sjellë zhvillim ekonomik për vendin si sektori i energjisë së rinovueshme ku AIC po zhvillon projektin e saj të parë.

Aktivite të AIC

Vizitë zyrtare në Ministrinë e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Investimeve në Greqi

Ky takim u zhvillua me zyrën e Zëvendës Ministrit të Zhvillimit dhe Investimeve, Kërkimit, Inovacioni dhe Teknologjisë për të diskutuar rreth zhvillimit dhe ekzekutimit të projekteve në fushën e inovacionit dhe teknologjisë dhe për të mësuar nga përvoja e Greqisë në lidhje me zhvillimin e Teknoparqeve dhe Qendrave të Inovacionit. AIC mori mjaft informacione me vlerë lidhur me mënyrën e ngritjes së teknoparqeve dhe drejtimit të tyre.

Vizitë studimore në "Hellenic Corporation of Assets and Participation" (HCAP)

Përfaqësues nga Korporata e Investimeve Shqiptare zhvilluan një vizitë studimore në Athinë me qëllim takimin me përfaqësues të korporatës së ngjashme greke. Qëllimi kryesor i vizitës ishte të mësohej nga përvoja e tyre dhe të eksplorohejshin mënyrat e mundshme të bashkëpunimit në të ardhmen. Gjithashtu u diskutua mundësia e nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet dy institucioneve dhe do të shqyrtohet më tej në muajt në vijim.

Green Destinations 2022 & The Future of Tourism

Qëllimi kryesor i konferencës ishte mbështetja e menaxherëve të destinacioneve dhe liderave të biznesit në ofrimin e turizmit më të mirë dhe më të qëndrueshëm, duke paraqitur histori suksesi dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira.

Përfaqësues nga AIC ishin gjithashtu pjesë e konferencës me qëllim përfitimin e më shumë njohurive, ideve dhe mundësive se si të zhvillohen destinacione të gjelbra në sektorin e turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri, si një nga sektorët ku AIC po zhvillon ide projektsh.

Zhvillimi i një *project pipeline* investimesh

Për vitin 2022, në fokus të AIC ka qënë zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve përgjatë fazave të ndryshme që nga identifikimi dhe konceptualizimi i idesë fillestare të projektit deri në përfundimin e vleresimit të fizibilitetit dhe tërheqjen e interesit të investitorëve.

AIC ka shqyrtuar 40 projekte potenciale investimi në fushat e industrisë dhe logjistikës, turizmit, energjisë, dhe bujqësisë, me qëllim identifikimin e atyre që ushqejnë potencialin më transformues nga këndvështrimi i 1) qëndrueshmërisë tregtare (potencialin komercial) dhe 2) ndikimit në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, i matur nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike dhe akumulimit të "know how" për të ndërtuar kapacitete të reja në vend.

Aktualisht janë zhvilluar mbi 14 (katërmbëdhjetë) ide/propozime projektesh investimi në sektorë të ndryshëm dhe ka kryer analiza për të validuar qëndrueshmërinë dhe bankabilitetin e tyre. Pjesë e këtyre analizave kanë qënë vlerësimi i asetëve, projektimi arkitektonik, llogaritja e kostove fillestare, modelet e mundshme të biznesit, hartimi i termave të referencës për studimet parafizibilitetit dhe/ose fizibilitetit si dhe zhvillimi i marrëdhënieve me palët e interesit, konkretisht, qeverinë, institucionet private dhe institucionet zhvillimore ndërkombëtare, për secilin projekt.

Nga këto analiza, AIC ka priorizuar 8 projekte investimesh, në fushat e energjisë se rinovueshme, industrisë, teknologjisë, inovacionit, dhe turizmit, të cilat ndodhen në faza të ndryshme zhvillimi. Disa prej tyre janë në fazën e strukturimit, dhe disa të tjera janë më të avancuara dhe pritet të bëhen gati për zbatim brenda vitit 2023, nëse nuk hasen pengesa apo vonesa.

Si rrjedhim, pritet që gjatë vitit 2023, si dhe gjatë 2-3 viteve pasardhëse, të konkretizohen investimet e para të AIC duke mobilizuar dhe kapitalin privat. Po kështu, gjatë vitit 2023, do të avancohet me projekte të reja, të cilat janë identifikuar tashmë.

Sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit për **financimin e aktiviteteve investuese**

Korporatat zhvilluese kapitalizohen në momentin e krijimit me asete dhe likuiditet monetar. Ky kapital është garanci që Korporata ka në raport me aksionerin, palët e treta dhe që mundëson krijimin e një plani pune në përputhje me misionin për të cilin ngrihet korporata. Në rastin tonë, AIC ka qenë e nën financuar dhe pa asete konkrete. Në një mënyrë, AIC ka funksionuar si një start-up me një kapital fillestar të vogël, në kërkim të aseteve dhe projekteve të investimit.

Në këtë kontekst, AIC ka kërkuar injektim të kapitalit për realizimin e detyrave të saj, dhe po ashtu për të pasur një pavarësi financiare. Në total, është vlerësuar se kapitali adekuat për AIC duhet të jetë përafërsisht midis 47 (dyzet e shtatë) milion Euro dhe 52 (pesëdhjetë e dy) milion Euro për përgatitjen dhe zhvillimin e projekteve dhe për ti dhënë një besueshmëri investitorëve private mbi shëndetin financiar të saj. Përveç kapitalit monetar, AIC synon gjithashtu rritjen e kapitalit të saj nëpërmjet transferimit të aseteve të nën përdorura shtetërore për të bërë të mundur rivitalizimin e tyre me projekte investimi.

Në fillim të vitit 2022, kapitali i AIC ishte në masën 2,198,000,000 (dy miliard e njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion) lekë. Gjatë vitit 2022 janë marrë disa vendime të rëndësishme mbi kapitalin e shoqërisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e Asamblesë së Përgjithshme, si më poshtë:

- Vendimi Nr. 112, mbi zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë me 2 000 000 000 (dy miliard) lekë.
- Vendimi Nr. 112/1, mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 2 000 000 000 (dy miliard) lekë.
- Shfuqizimin e Vendimit Nr. 98, date 15/09/2022 për rritjen e kapitalit me 200 000 000 (dyqind milion) lekë.
- Vendimi Nr. 113/1, mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me 120 000 000 (njëqind e njëzet milion) lekë.

4

Sfidat dhe Objektivat për vitin 2023

Sfidat & Objektivat për vitin 2023

Si çdo institucion i ri, AIC vazhdon të përballet me sfida të ndryshme të cilat janë të pritshme në fillimet e jetës së një kompanie. Sfidat kryesore të AIC-së për vitin 2023 përfshijnë: ndërveprimin me ekosistemin institucional dhe konkludimin e bashkëpunimit me institucione partnere për zhvillimin e projekteve të investimit; sigurimin e kapitalizimit të mjaftueshëm për të garantuar përmbushjen e misionit; konsolidimin e qeverisjes së Korporatës; dhe menaxhimin e perceptimit të publikut dhe audiencave të caktuara për natyrën dhe funksionet e AIC-së.

Për vitin 2023, drejtimet kryesore të punës së Korporatës janë të orientuara në katër boshte kryesore:

- Konsolidimi i organizimit të brendshëm dhe ngritja e kapaciteteve;
- Zhvillimi i linjës së projekteve të investimit;
- Ngritja, formalizimi dhe konsolidimi i marrëdhënieve me partnerët;
- Kapitalizimi i AIC-së.

Sfidat & Objektivat për vitin 2023

Lidhur me pikën 1, AIC planifikon të vijojë me ngritjen e kapaciteteve të stafit në mënyrë që të mundësoj zhvillimin e projekteve cilësore që kanë potencialin e duhur për të tërhequr kapitalin privat dhe për të gjeneruar të ardhura dhe zhvillim.

Lidhur me pikat 2 dhe 3, AIC synon të avancojë bashkëpunimin me institucionet partnere për konkretizimin e projekteve të identifikuara dhe të krijojë sinergji të reja me aktorë të ndryshëm vendas dhe të huaj. Më konkretisht, AIC edhe gjatë vitit 2023 do të fokusohet në:

- Identifikimin dhe përkufizimin e projekteve;
- Dizajnimin e aspekteve inxhinierike/teknike të projekteve;
- Përgatitjen e modelit financiar dhe ligjor, duke vlerësuar koston e projektit, impaktin në zhvillimin e vendit, si edhe potencialin komercial për AIC-në;
- Kuantifikimin e inputeve publike si prona, investime publike dhe kostot e përgatitjes së projektit;
- Krijimin e raporteve me investitorë privatë potencial.

Lidhur me pikën 4, përveç fondeve (kapitalit) të injektuara nga aksioneri, AIC ka filluar procedurën për transferimin e aseteve të para të paluajtshme. Një kapitalizim më i lartë do të përkthehet në më shumë mundësi për të zhvilluar projekte të suksesshme të cilat do bëjnë të mundur kthimin e aseteve të fjetura shtetërore në projekte të mirëfillta që sjellin zhvillim për ekonominë e vendit.

Mund të na gjeni në

- www.aicorporation.al
- info@aicorporation.al

